



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS  
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA  
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION  
Adresa: Rr. "AgimRamadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0) 38 244 473  
e-mail: [info@fshsk.org](mailto:info@fshsk.org), [gezim.hazrolli@fshsk.org](mailto:gezim.hazrolli@fshsk.org)

---

## S A T U T I

### I

## FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS

Prishtinë 11/11/2022

Mbështetur në Nenet 27-33 të Ligjit Mbi Sportin e Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 2003/24), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-075, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-115; Udhëzimin Administrativ (MKRS) Nr.01/2022 për Kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive; Mbështetur në Ligjin Nr. **06/L-043** për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës;

Mbështetur në Nenin 31 të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, të datës 01/02/2020, Me qëllim të përputhjes me Statutin e ISSF-së dhe Statutin e KOK-ut, si dhe Udhëzimit Administrativ (MKRS) Nr.01/2022 për Kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive, Kuvendi i Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me dt 11/11/2022, në Prishtinë miraton këtë

# STATUT

## I FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1. Emërtimi, statusi juridik dhe adresa e Federatës

1. Emri i Federatës është **Federata e Shenjëtarisë Sportive e Kosovës**, themeluar më 17/11/2000 dhe anëtarësuar në ISSF më 04/05/2015
2. Emri i Federatës në korrespondencën ndërkombëtare, në gjuhën angleze është: "**Kosovo Shooting Sport Federation**"
3. Federata e Shenjëtarisë Sportive, e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: FSHSK) është pjesë e lëvizjes olimpike në Kosovë, si organizatë gjithëpërfshirëse dhe e pandashme e sportit të shenjëtarisë
4. FSHSK është e vetmja Federatë e autorizuar për organizimin e sportit të shenjëtarisë në Kosovë dhe si e tillë, FSHSK është themeluese dhe anëtare me të drejta të plota e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), si dhe është anëtare me të drejta të plota e Konfederatës Evropiane të Shenjëtarisë dhe Federatës Ndërkombëtare të Shenjëtarisë Sportive (ISSF).
5. Si anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Konfederatës Evropiane të Shenjëtarisë (ESC) dhe Federatës Ndërkombëtare të Shenjëtarisë Sportive (ISSF), FSHSK angazhohet për zbatimin e parimeve të Lëvizjes Olimpike, si: forcimin e miqësisë dhe bashkëpunimit me Federatat e tjera në KOK, si dhe Federatat e tjera brenda ISSF-së, parandalimin e diskriminimit, parandalimin e dopingut, promovimin e paqes dhe ngritjen e pjesëmarrjes së femrave në sport, si dhe ruajtjen e ambientit.
6. FSHSK nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë, për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e FSHSK-së, do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të saj dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, Kryetarin, nëpunësit, ndonjë anëtar të FSHSK-së, ndonjë të punësuar apo donator të FSHSK-së. Megjithatë, pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona, mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë FSHSK.

7. Selia e Federatës është në **Prishtinë, Rr. Agim Ramadani Nr. 43**.
8. Si nivel kombëtar i organizimit të shenjëtarisë sportive, FSHSK është vazhdimësi e Lidhjes së Shenjëtarisë në Kosovë, të themeluar në Prishtinë më 06. mars 1948.

## **Neni 2. Simbolet e FSHSK-së**

1. Simbolet e Federatës janë emblema (logoja), vulat dhe flamuri.
2. Emblema (logoja) e FSHSK-së përbëhet prej katërkëndëshit me ngjyrë të kaltër, në të cilin është e vendosur harta e Republikës së Kosovës me ngjyrë ari, në të cilën janë vizatur tre rrrathë koncentrik me katër ndërprerje kryqëzore me pike të theksuar të zezë në mes, kurse nën hartë ndodhet shkurtesa FSHSK.
3. Flamuri i FSHSK-së ka ngjyrën e kaltër sipas përkrahimit nga paragrafi paraprak më dimensione dhe përmasa 2 : 1.
4. FSHSK-ja ka vulën e rumbullakët dhe vulën katërkëndëshe. Vula e rumbullakët ka diametrin 25 mm, rrethin ku është shkruar emri i plotë i FSHSK-së në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, kurse në mes është harta e Kosovës me tre rrrathë në mes me ndërprerje kryqëzore dhe pike të theksuar në mes.

## **II. MISIONI, ROLI, QËLLIMET DHE TË DREJTAT**

### **Neni 3. Misioni**

1. Misioni i FSHSK-së është që
  - 1.1. të promovojë dhe udhëheq zhvillimin e sportit të shenjëtarisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pa diskriminim të çfarëdo lloji, si dhe të forcojë lidhjet e miqësisë dhe bashkëpunimit me Federatat e tjera brenda KOK-ut, si dhe me Federatat e ngjashme të vendeve tjera, brenda ESC-së dhe ISSF-së, duke u mbështetur në parimet themelore të olimpizmit, siç janë përcaktuar në Kartën Olimpikë

### **Neni 4. Qëllimet**

1. FSHSK ka për synim të vazhdueshëm ngritjen e cilësisë së shenjëtarisë sportive dhe arritjes së rezultateve kulmore, duke përfshirë edhe Lojërat Olimpikë.
  - 1.1. FSHSK, funksionon duke marrë parasysh qëllimet e përcaktuara me këtë Statut, shprehimisht zotohet se do të punojë për arritjen e qëllimeve të mëposhtme:
  - 1.2. Masivizimi, zhvillimi cilësor dhe organizimi i Shenjëtarisë sportive në Kosovë;
  - 1.3. Sigurimi i kushteve për veprimtarinë e të gjitha kategorive të përfaqësueses kombëtare të FSHSK-së;
  - 1.4. Avancimi profesional i garuesve, trajnerëve, gjyqtarëve, dhe akterëve tjerë në sportin e shenjëtarisë;
  - 1.5. Sigurimi i ndihmës për organizatat dhe subjektet tjera që kanë për qëllim promovimin e sportit të shenjëtarisë, në përputhje me aktet normative të FSHSK-së;
  - 1.6. Organizimi i veprimtarisë sportive në shenjëtari për të gjitha kategoritë dhe gjinitë, si dhe përcaktimi i sistemeve të garave për të njëjtat;
  - 1.7. Avancimi i shenjëtarisë sportive përmes pjesëmarrjes në gara dhe evenimente ndërkombëtare;

- 1.8. Mbështetja e zhvillimit të shenjëtarisë sportive në tërë territorin e Kosovës, me theks të veçantë në vendet ku ajo është më pak e zhvilluar;
  - 1.9. Organizimi i kampeve, seminareve, punëtorive, publikimeve profesionale, etj. me qëllim të avancimit të shenjëtarisë sportive;
  - 1.10. Sigurimi i bazës materiale për zhvillimin e veprimtarisë së FSHSK-së, si dhe për mbështetjen e klubeve dhe anëtarëve të saj;
  - 1.11. Luftimi i përdorimit të dopingut dhe substancave të ndaluara, në përputhje me aktet normative të KOK-ut, ISSF-së, dhe me Rregulloren për Anti-Doping të FSHSK-së;
  - 1.12. Adoptimi dhe promovimi i vlerave olimpike.
2. Federata nuk kufizohet në ndërmarrjen e veprimeve vetëm për arritjen e caqeve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

### **Neni 5. Objektivat**

2. Për arritjen e misionit të vetë, FSHSK, në veçanti
  - 2.1. bashkëpunon me KOK-un, ESC-në, ISSF-në dhe akterët tjerë, me qëllim të organizimit të shenjëtarisë sportive, si dhe për zhvillimin e kushteve të nevojshme teknike e profesionale
  - 2.2. organizon garat për junior dhe senior, si dhe rregullon çështjet teknike e materiale lidhur me to
  - 2.3. mbështet aktivitetet dhe angazhimin e klubeve anëtare për zhvillimin e shenjëtarisë sportive
  - 2.4. ofron mbështetje për klubet anëtare dhe garuesit individual, rezultatet e të cilëve kanë kontribuar në plotësimin e misionit të FSHSK-së
  - 2.5. mirëmban radhitjen e rezultateve të garuesve, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
  - 2.6. harton, miraton, ndryshon dhe përditëson rregullat dhe udhëzimet
  - 2.7. licencon klubet, garuesit, trenerët dhe referët, si dhe bënë inspektimin e tyre, sipas rregulloreve në fuqi
  - 2.8. zhvillon dhe promovon programe edukative-arsimore të fushës së shenjëtarisë sportive
  - 2.9. bënë njoftime publike lidhur me veprimtarinë e vet
  - 2.10. ndanë çmime dhe shpërblime për individë të cilët kanë arritur rezultate të dalluara në aktivitetin e tyre drejtë plotësimit të misionit të FSHSK-së
3. Për arritjen e misionit dhe qëllimeve të veta, FSHSK do të ruaj autonominë e vet dhe nuk do t'i nënshtrohet presioneve të çfarëdo lloji dhe prej çfarëdo burimi qoftë.
4. Gjatë realizimit të misionit dhe qëllimeve të veta, FSHSK do të përfaqësojë interesat e veta dhe të anëtarëve të vet, kundrejt organizatave tjera sportive kombëtare e ndërkombëtare.

### **Neni 6. Të drejtat**

1. Me qëllim të realizimit të misionit të vetë, FSHSK mundet të bashkëpunojë me organet qeveritare (në veçanti Departamentin e Sportit të Ministrisë përkatëse, si dhe drejtoritë komunale të sportit) dhe të punojë në zhvillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve harmonike dhe të dobishme me këto organe, me mirëkuptim reciprok dhe duke respektuar autoritetin dhe juridiksionin e tyre.

2. Për arritjen e misionit të vetë dhe realizimit të qëllimeve të veta programore, FSHSK ka të drejtë të kërkojë burime financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mënyra të cilat janë në përputhje me Kartën Olimpikë dhe rregullat përkatëse.

### **III. ÇËSHTJET E ANËTARËVE**

#### **Neni 7. Anëtarësimi**

1. Anëtarësia në FSHSK-së është e hapur për të gjithë klubet e shenjëtarisë sportive, të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës, qoftë OJQ, ose klube private.
2. Klubet të cilat janë të regjistruar si OJQ, duhet të plotësojnë kërkesat ligjore përkatëse, të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
3. Të gjitha klubet, duhet të plotësojnë kërkesat ligjore, të përcaktuara në Ligjin Mbi Sportin (Ligji Nr. 2003/24), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-075, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-115, Udhëzimin Administrativ të MKRS-së Nr.01/2022 për Kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të Federatave dhe Organizatave Sportive;
4. Të gjitha klubet, duhet të plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-075 për Parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-118.
5. Shumën e pagesës për anëtarësi, si dhe afatin për kryerjen e pagesës, e përcakton Këshilli Drejtues.

#### **Neni 8. Kushtet dhe mënyra e anëtarësimit**

1. Për të qenë anëtar të FSHSK-së, klubet duhet të plotësojnë kërkesat ligjore, të vlefshme në kohën e regjistrimit.
2. Për t'u anëtarësuar, klubet dorëzojnë kërkesën me shkrim, në të cilën zotohen se do të respektojnë të gjitha parimet dhe vlerat e FSHSK-së, Statutin e FSHSK-së dhe vendimet e organeve dhe komiteteve të FSHSK-së. Kjo deklaratë duhet të përfshihet edhe në Statutin e Klubit. Së bashku me kërkesën, klubet do të dorëzojnë edhe dokumentacionin e nevojshëm:
  - 2.1. Deklarata me shkrim për respektimin e Statutit dhe të gjitha akteve normative të Federatës;
  - 2.2. Certifikata e regjistrimit të klubit apo shoqatës;
  - 2.3. Të dhënat dhe nënshkrimet e themeluesve të subjektit dhe emrat e personave të autorizuar për përfaqësim të tij;
  - 2.4. Të dhënat mbi xhirollogarinë e subjektit;
  - 2.5. Aktet normative të subjektit (Statuti, Rregullorja për Punën e Kuvendit, Rregullorja për Punën e Këshillit Mbikëqyrës).

## **Neni 9. Vendimi për anëtarësim**

1. Vendimin mbi kërkesën për anëtarësim të klubeve e merr Kuvendi i FSHSK-së.
2. Anëtarësimi dhe përjashtimi do të miratohen përkohësisht nga K.D i FSHSK-së, ndërsa pranimin dhe përjashtimin përfundimtar e bën Kuvendi i FSHSK-së në mbledhjen e radhës, me më tepër se 50%+1 ose 2/3 e anëtarëve të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.
3. Sekretari i FSHSK-së do të shqyrtojë dokumentacionin e dorëzuar, do të vlerësojë përputhshmërinë e këtyre dokumenteve me parimet, vendimet dhe aktet e vlefshme të FSHSK-së, si dhe do të vlerësojë dëshmitë për veprimtarinë e Klubit, në përputhje me misionin dhe qëllimet e FSHSK-së.
4. Nëse Kuvendi i FSHSK-së ka vendosur pozitivisht për anëtarësimin, Klubi duhet të kryej pagesën e anëtarësisë, brenda afatit prej 15 ditëve nga data e pranimin të vendimit. Nëse pagesa nuk është kryer, atëherë llogaritet se Klubi ka hequr dorë nga anëtarësimi.
5. Sekretari i Përgjithshëm i FSHSK-së do të mirëmbajë regjistrin e anëtarëve të FSHSK-së. Ky regjistër, ndër të tjera, duhet të përfshijë informatat në vijim: emërtimin e plotë të anëtarit, adresën e selisë, datën e anëtarësimit (dhe kopjen e vendimit të Kuvendit të FSHSK-së me të cilin i është pranuar anëtarësimi), personin e autorizuar, listën e garuesve të licencuar të Klubit. Ky regjistër duhet të jetë në dispozicion në çdo kohë dhe do të shërbejë si referencë për thirrjen e Kuvendit të FSHSK-së

## **Neni 10. Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve**

1. Anëtarët e FSHSK-së kanë të drejtë:
  - 1.1. të dërgojnë delegatët e tyre në Kuvendin e Përgjithshëm të FSHSK-së, në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit të FSHSK-së
  - 1.2. të propozojnë kandidatët për zgjedhje në organet dhe komisionet e FSHSK-së
  - 1.3. të dorëzojnë propozime për shqyrtim nga organet e FSHSK-së, duke përfshirë edhe Kuvendin e Përgjithshëm të FSHSK-së
  - 1.4. të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga FSHSK, në përputhje me rregullat e zbatueshme
  - 1.5. të kërkojnë leje për organizimin e garave dhe aktiviteteve tjera, në përputhje me rregulloren e garave të FSHSK-së
  - 1.6. të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera, të cilat u janë të lejuara sipas këtij Statuti dhe/apo vendimeve të organeve përkatëse të FSHSK-së
  - 1.7. të jenë rregullisht të informuar për aktivitetet e FSHSK-së dhe për vendimet e organeve dhe/apo komisioneve të FSHSK-së
2. Anëtarët e FSHSK-së kanë për detyrë:
  - 2.1. të zbatojnë këtë Statut, si dhe rregulloret, udhëzimet dhe vendimet e organeve dhe komiteteve të FSHSK-së, duke përfshirë Kartën Olimpikë, Kodin e etikës së FSHSK-së, Kodin e etikës të KOK-ut, etj.
  - 2.2. të marrin pjesë me garuesit e tyre, në së paku tri gara gjatë vitit, të organizuara nga FSHSK
  - 2.3. të marrin pjesë në aktivitetet e tjera të organizuara nga FSHSK
  - 2.4. të përmbushin detyrat e përcaktuara nga FSHSK me qëllim të promovimit dhe masivizimit të shenjëtarisë sportive, në territorin në të cilin veprojnë

- 2.5. të paguajnë anëtarësinë, siç është përcaktuar nga KD e FSHSK-së
- 2.6. të paguajnë tarifën për licencimin e klubeve, siç është përcaktuar nga KD e FSHSK-së
- 2.7. të paguajnë tarifën për licencimin e garuesve, siç është përcaktuar nga KD e FSHSK-së

#### **Neni 11. Vazhdimi i anëtarësisë së klubeve**

1. Këshilli Drejtues, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe përmes komiteteve përkatëse, do të përcjell veprimtarinë e klubeve dhe do të bëjë vlerësimin e klubeve, për të parë nëse i përmbushin detyrimet e tyre. Klubeve të cilat me rregull i përmbushin detyrimet e tyre, do t'u vazhdohet anëtarësia në FSHSK
2. Nëse një Klub, nuk i përmbush detyrimet e veta si anëtar i FSHSK-së, KD do t'i dërgojë vërejtje me shkrim, në të cilin do të njoftojë Klubin për detyrimet e papërmbushura dhe do të caktojë një afat të arsyeshëm për përmbushjen e detyrimeve.

#### **Neni 12. Pezullimi i anëtarësisë së Klubit**

1. Anëtarësia e një klubi do të pezullohet nëse:
  - 1.1. nuk ka kryer pagesën e anëtarësisë për vitin e kaluar, apo nuk ka kryer pagesën për licencimin e klubit për vitin e kaluar
  - 1.2. nuk ka marrë pjesë në së paku tri gara të organizuara nga FSHSK, gjatë periudhës për të cilën ka qenë i licencuar
  - 1.3. ka bërë shkelje të këtij Statuti, rregullave, parimeve, apo vendimeve të organeve dhe/apo komisioneve të FSHSK-së
  - 1.4. nuk dërgon delegatët për të marr pjesë në Kuvendin e FSHSK-së
2. Vendimin preliminar për pezullimin e anëtarësisë së anëtarëve e merr K.D, ndërsa vendimin për përjashtimin e miraton Kuvendi i Federatës me vendim të më tepër se 50%+1 ose 2/3 e delegatëve të pranishëm në Kuvend.
3. Në rast të pezullimit, Klubi nuk do të ketë të drejtë të dërgojë delegatët në Kuvendin e radhës të FSHSK-së, e as të marr pjesë në aktivitetet e organizuara nga FSHSK-ja, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në gara. Klubi i pezulluar, nuk do të merret parasysh gjatë përlllogaritjeve për kuorum të Kuvendit të FSHSK-së.

#### **Neni 13. Përjashtimi i Klubit**

1. Kuvendi i FSHSK-së do të vendos për përjashtimin e ndonjë Klubi, zyrtari, ose sportisti, nëse:
  - 1.1. ka bërë shkelje të rëndë të këtij Statuti, rregullave (duke përfshirë kodin e etikës e të mirësjelljes, rregullat anti-doping, etj), Ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës, parimeve dhe/apo vendimeve të organeve, apo komisioneve të FSHSK-së, i ka shkaktuar dëm materiale, apo të autoritetit të FSHSK-së, apo ka bërë shkelje të ligjeve të zbatueshme në vend
  - 1.2. është shuar
  - 1.3. ka bërë kërkesë për ndërprerje të anëtarësisë
  - 1.4. ka kaluar më tepër se një vit nga suspendimi dhe Klubi, zyrtari, ose sportisti, nuk ka ndërmar hapat e nevojshëm për të përmirësuar gjendjen

2. Vëndimin përfundimtar për përjashtim e bën Kuvendi i FSHSK-së në mbledhjen e radhës, me më tepër se 50%+1 ose 2/3 e anetareve të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.
3. Për të mos penguar aktivitetin sportiv të garuesve, KD mundet të lejojë kalimin e garuesve nga Klubi i përjashtuar tek ndonjë klub tjetër. Nëse afati për kalim në klub tjetër është i shkurtër, KD mundet të marr vendim dhe t'u lejojë atyre pjesëmarrjen në gara, në emër të FSHSK-së, pa u anëtarësuar në ndonjë klub. Pas përfundimit të garës, anëtarët duhet të bëjnë zgjedhje për vazhdimin e aktivitetit të tyre në ndonjë Klub aktiv të FSHSK-së.

#### **IV. ORGANET E FSHSK-SË**

##### **Neni 14. Organet e FSHSK-së**

1. FSHSK e realizon veprimtarinë e vet përmes organeve, personave dhe komisioneve në vijim:
  - Kuvendi i Përgjithshëm
  - Këshilli Drejtues
  - Kryetari
  - Nënkryetarët
  - Sekretari i Përgjithshëm
  - Këshilli Mbikëqyrës
  - Komisioni Disiplinor
  - Komisionit të ankesave
  - Komisionit Statutar
  - Komisionet e tjerë
2. Ndonëse anëtarët individual të organeve dhe komisioneve të FSHSK-së mundet të sjellin njohuritë, përvojat dhe shkathtësitë e veta nga klubet e veta, ata duhet të ushtrojnë detyrat e veta si anëtar të një organi, apo komisioni të FSHSK-së në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke pasur parasysh vetëm interesat e FSHSK-së si tërësi
3. Të gjithë anëtarët e organeve dhe/apo komisioneve të FSHSK-së, duhet të promovojnë interesat e FSHSK-së dhe të zbatojnë vendimet e organeve dhe komisioneve të FSHSK-së.
4. Një person, mundet të zgjidhet vetëm në një organ, apo komision të FSHSK-së
5. Të gjithë personat e zgjedhur në organet dhe komisionet e FSHSK-së, do të punojnë në baza vullnetare dhe pa rrogë, por, me vendim të KD-së, atyre mundet t'u kompensohen shpenzimet lidhur me aktivitetet e tyre për nevoja të FSHSK-së. Sekretarit të Përgjithshëm, në përputhje me buxhetin e FSHSK-së dhe me legjislacionin në fuqi, do t'i caktohet pagë, si udhëheqës i administratës së FSHSK-së.

##### **Neni 15. Zgjedhja në organet dhe komisionet e FSHSK-së**

1. Për t'u zgjedhur në ndonjë organ, apo komision të FSHSK-së, personi duhet të ketë pajtimin e Klubit nga i cili vjen (të ketë bazën deleguese). Pëlqimi duhet të dorëzohet së paku tri ditë përpara mbajtjes së mbledhjes në të cilën do të bëhet votimi
2. Të gjitha organet dhe komisionet e përhershme të FSHSK-së, zgjidhen për mandat katër-vjeçar. Ky mandat fillon pas zgjedhjeve në Kuvendin e Rregullt Zgjedhor dhe përfundon pas katër viteve, përpara Kuvendit të Rregullt Zgjedhor



3. Çdo anëtar i një organi, apo komisioni, mundet të shërbej më së shumti 12 vite, në atë pozitë. Moshë maksimale për nominim është 75 vite, e llogaritur në ditën e zgjedhjeve.
4. Anëtari i një organi, apo komisioni të FSHSK-së, nuk do të marr pjesë në shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me Klubin nga i cili është i nominuar, apo në të cilin gjendet aktualisht, apo për çështjet në të cilat ai/ajo ka konflikt interesi.

#### **Neni 16. Vendimmarrja**

1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë Statut, vendimet e një organi, apo komisioni të FSHSK-së, janë të plotfuqishme, nëse merr shumicën e thjeshtë, të votave të hedhura. Abstenimet nuk do të llogariten. Në rast të barazimit, vota e Kryesuesit të organit, apo komisionit, do të llogaritet vendimtare.
2. Vendimet në organet dhe komisionet e FSHSK-së merren me votim të hapur, përpos nëse votimi i fshehtë kërkohet nga së paku 1/3 e anëtarëve të organit, apo komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje.
3. Të gjithë vendimet do të hyjnë në fuqi menjëherë, përveç nëse organi, apo komisioni i cili e merr vendimin e cakton një afat tjetër
4. Zgjedhjet duhet të bëhen me vota të fshehta. Nëse numri i kandidatëve është i barabartë me numrin e vendeve të lira që do të zgjidhen, organi që drejton zgjedhjet mundet të vendosë që zgjedhjet të bëhen me vota të hapura, apo me aklamacion
5. Për t'u zgjedhur në cilindo organ, apo pozitë, brenda FSHSK-së, personi duhet të fitojë gjysmën e votave të hedhura. Nëse në rrethin e parë të votimeve, nuk kalojnë numër i mjaftueshëm i kandidatëve, atëherë, do të organizohet rrethi i dytë. Në rrethin e dytë, do të marrin pjesë kandidatët të cilët nuk kanë kaluar në rrethin e parë. Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet me shumicë relative (do të zgjidhen kandidatët të cilët kanë më së shumti vota, pavarësisht nëse e kanë kaluar gjysmën e votave të hedhura, apo jo). Nëse dy, apo më shumë kandidatë që gjenden në fund të listës së kandidatëve që do të kalojnë, kanë numër të barabartë të votave, atëherë, për ta, do të organizohet edhe një rreth i votimit, me ç'rast, kandidatët që kanë marrë më së shumti vota, do të kalojnë. Nëse edhe pas këtij votimi, numri i votave është i barabartë, Kryesuesi i organit që drejton votimin, do të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve që kalojnë, përmes shortit
6. Në rast të votimit të fshehtë, votuesi ka të drejtë të votojë aq kandidatë sa janë kërkuar, ose më pak (pra, nuk guxon të zgjedhë më tepër persona, se sa është numri i kandidatëve të kërkuar). Përndryshe, vota e hedhur do të llogaritet si e pavlefshme. Të pavlefshme do të llogariten edhe fletëvotimet që kanë të shënuar emrat gabimisht, fjalë të paqarta, apo fyese.

#### **Neni 17. Përfaqësimi dhe prezantimi**

1. FSHSK-në e përfaqëson dhe e prezanton Kryetari i Federatës, në përputhje me Ligjin dhe Statutin e FSHSK-së.
2. Në rast të pamundësisë, apo mungesës së Kryetarit, nëpër takime, FSHSK-në e prezantojnë Nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm, përkatësisht anëtarët e autorizuar të KD, nëse për këtë i autorizon KD, me vendim të veçantë. Të përmendurit, mundë të përfaqësojnë FSHSK-në, nëse për këtë i autorizon KD me prokurë të veçantë.
3. Në raste të jashtëzakonshme, kur Kryetari mungon, apo nuk mundet të kryej detyrat e prezantimit dhe/apo përfaqësimit, ndërsa askujt nuk ia ka bartur autorizimin përkatës, FSHSK prezantohet dhe përfaqësohet nga Nënkryetari.

4. Në rast të takimeve në ndonjë fushë të veçantë, FSHSK-në mundën ta përfaqësojnë edhe anëtarët e tjerë të saj, në bazë të autorizimit nga KD.
5. Të deleguarit, të zgjedhurit, të emëruarit dhe personat e punësuar në Federatë, për punën dhe veprimet e tyre janë përgjegjës para atyre organeve që i kanë deleguar, zgjedhur, emëruar apo angazhuar në punë, në përputhje me këtë Statut, aktet e tjera të FSHSK-së, dhe në mandatin dhe kompetencat e dhëna.
6. Zyrtarët e FSHSK-së, anëtarët e organeve të FSHSK-së, të punësuarit, sportistët, si dhe personat e angazhuar, përgjigjen para organeve disiplinore sipas procedurave të parashikuara me akte normative të FSHSK-së dhe me ligj.

### **Neni 18. Kuvendi i Përgjithshëm**

1. Kuvendi i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë i FSHSK-së. Kuvendi mundet të jetë i Rregullt, që do të mbahet çdo vit, ose i Jashtëzakonshëm, nëse ftohet nga Këshilli Drejtues, apo me kërkesë të së paku 1/3 së anëtarëve të FSHSK-së, me të drejtë vote.
2. Kuvendi i Përgjithshëm përbëhet nga dy delegat, nga secili Klub anëtar, nëse ai Klub është anëtarësuar së paku para gjashtë muajve. Listën e klubeve anëtarë të cilët i plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në Kuvend, e verifikon KD në mbledhjen përpara Kuvendit.
3. Kryetari, Nënkryetarët, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe të komisioneve të FSHSK-së, si dhe Sekretari i Përgjithshëm, kanë vetëm rol konsultativ dhe nuk kanë të drejtë vote në Kuvendin e FSHSK-së, përveç nëse përfaqësojnë ndonjë Klub anëtar të FSHSK-së.
4. Vetëm Kryetari, Nënkryetari, Sekretari i Përgjithshëm, apo anëtari i Këshillit Drejtues, kanë të drejtë të jenë delegat të një Klubi anëtar, në Kuvendin e FSHSK-së. Lista e delegatëve duhet të arrij tek Sekretari i Përgjithshëm, jo më larg se shtatë ditë përpara datës së mbajtjes së Kuvendit. Secili delegat, para hyrjes në Kuvend, duhet të sjellin dëshminë e delegimit nga Klubi përkatës.
5. Klubet do të mundohen që femrat të jenë të përfaqësuara në mesin e delegatëve. Pjesëmarrja në Kuvend përmes autorizimit (Proxy) nuk lejohet.
6. Pas hapjes së Kuvendit nga Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm duhet thirr delegatët me emër, për të vërtetuar pjesëmarrjen dhe kuorumin e delegatëve në Kuvend. Pas përfundimit të leximit të emrave, Sekretari do të njoftojë për numrin e votave të vlefshme dhe do të vërtetojë nëse Kuvendi ka kuorum të mjaftueshëm për të vazhduar.

### **Neni 19. Mbledhjet e Kuvendit**

1. Kuvendi i Rregullt, apo i Jashtëzakonshëm, ftohet me ftesën e nënshkruar nga Kryetari i FSHSK-së. Ftesa duhet të përmbajë datën, orën, vendin e mbajtjes së Kuvendit dhe u dërgohet klubeve anëtare, së paku 30 ditë përpara datës së mbajtjes së Kuvendit, së bashku me Rendin e Ditës, si dhe me të gjitha materialet të cilat duhet të shqyrtohen në Kuvend dhe mbi të cilat duhet të vendoset.
2. Nëse Kryetari nuk e thërret Kuvendin, sipas paragrafit të mëparshëm dhe nëse kushtet tjerë janë plotësuar (sipas Neni 18), Mbledhja e Kuvendit mundet të thirret nga Këshilli Drejtues, ose nga përfaqësuesit e autorizuar të së paku 1/2 e klubeve anëtare.
3. Kuvendin e Rregullt, apo të Jashtëzakonshëm të FSHSK-së, e udhëheq Kryetari i FSHSK-së, apo në rast të mungesës, apo pamundësisë së tij, nga Nënkryetari i parë i FSHSK-së.

4. Në rast se Mbledhja e Kuvendit është thirrur sipas paragrafit 2. më lartë, Kryesinë e Kuvendit e zgjedhë vetë Kuvendi, pas verifikimit të mandateve nga Sekretari i Përgjithshëm.
5. Kuvendi i Rregullt mundet të procedojë në mënyrë të rregullt, për të gjitha çështjet të cilat janë paraparë në Rendin e Ditës. Propozimet e klubeve anëtare, lidhur me Rendin e Ditës, duhet të arrijnë tek Këshilli Drejtues, së paku 20 ditë përpara datës së mbledhjes së Kuvendit. Nëse duhet të bëhet ndryshim në Rendin e Ditës, për këtë duhet të njoftohen të gjithë klubet anëtarë, e sipas nevojës, të shtyhet data e mbajtjes së Kuvendit.
6. Kuvendi i Rregullt, gjatë shqyrtimit të Rendit të Ditës, mundet aty-për-aty, të vendosë për shtimin e ndonjë pike të Rendit të Ditës, me vendim të 2/3 së votave të delegatëve të pranishëm dhe me të drejtë vote. Pas miratimit të Rendit të Ditës, nuk munden të bëhen ndryshime në të.
7. Kuvendi i Jashtëzakonshëm mundet të procedojë vetëm çështjet për të cilat është thirrur dhe nuk mundet të shqyrtojë, apo të vendosë për asnjë çështje tjetër.
8. Për të vazhduar Mbledhja e Kuvendit, të pranishëm duhet të jenë delegatët nga së paku gjysma (50%) e klubeve anëtarë, me të drejtë vote. Nëse ky kuorum nuk arrihet, Mbledhja e Kuvendit duhet të shtyhet për shtatë (7) ditë.
9. Pas Kuvendit Zgjedhor dhe pas çdo ndryshimi në udhëheqjen e FSHSK-së (Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm), për këtë duhet të njoftohet Departamenti i Sportit i Ministrisë përkatëse, KOK-u, ESC-ja dhe ISSF-ja.
10. Komisioni për verifikimin e procesverbalit, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, do të përpilojë procesverbalin pas Mbledhjes së Kuvendit, i cili do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës nga Këshilli Drejtues. Pas miratimit nga Këshilli Drejtues, procesverbali i nënshkruar nga komisioni dhe nga Kryetari i FSHSK-së, duhet t'u përcillet anëtarëve të FSHSK-së brenda 30 ditëve pas Mbledhjes së Kuvendit.

## **Neni 20. Autorizimet e Kuvendit**

1. Kuvendi i FSHSK-së ka të drejtat dhe autorizimet e caktuara me këtë Statut, në veçanti si vijon:
  - 1.1. zgjedh komisionin verifikues të delegatëve të Kuvendit
  - 1.2. miraton rendin e ditës së Kuvendit
  - 1.3. cakton komisionin për mbajtjen e procesverbalit, me propozim nga Këshilli Drejtues
  - 1.4. miraton dhe ndryshon Rregulloret: Punës së Kuvendit, Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës
  - 1.5. miraton raportet e organeve të FSHSK-së
  - 1.6. nëse kërkohet, vendosë për vendimet e organeve të FSHSK-së, të miratuara në periudhën ndërmjet dy Kuvendeve
  - 1.7. pranon dhe miraton raportin e auditorit të jashtëm
  - 1.8. miraton raportin financiar dhe planin e buxhetit
  - 1.9. miraton planin e punës dhe politikat e zhvillimit, operimit dhe funksionimit të FSHSK-së
  - 1.10. miraton Strategjinë e FSHSK-së
  - 1.11. miraton Kodin etik të sjelljes
  - 1.12. shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues
  - 1.13. vendosë për kërkesat e Klubeve anëtare, sipas autorizimeve të veta
  - 1.14. miraton, interpreton dhe ndryshon Statutin e FSHSK-së

- 1.15. zgjedh Kryetarin, shtatë (7) anëtarë të Këshillit të Drejtues, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët e Këshillit Disiplinor
  - 1.16. cakton Auditorin e jashtëm
  - 1.17. ndanë titullin “Anëtar Nderi” dhe “Kryetar Nderi” me propozim të Këshillit Drejtues
  - 1.18. vendosë për anëtarësimin e FSHSK-së në organizata ndërkombëtare, sipas propozimit të Këshillit Drejtues
  - 1.19. vendosë për shuarjen e FSHSK-së
  - 1.20. vendosë për çdo çështje tjetër, e cila vihet në Rend Dite, pas pranimit të mendimit nga Komisioni përkatës, ose nga Këshillit Drejtues, në përputhje me këtë Statut
2. Kuvendi i FSHSK-së mund të delegojë ndonjë prej autorizimeve, apo detyrave të tij, në organin tjetër udhëheqës të ndërmjetëm (Këshilli Drejtues), ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, me përjashtim të autorizimeve dhe detyrave, të cilat nuk delegohen sipas nenit 13. të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

### **Neni 21. Këshilli Drejtues**

1. Këshilli drejtues përbëhet prej 11 anëtarëve - Kryetarit të Federatës dhe dhjetë (10) anëtarëve. Shtatë (7) prej tyre, zgjedhen nga Kuvendi i Federatës, prej listës së kandidatëve të nominuar nga klubet anëtare, ndërsa 3 anëtarë i zgjedh (koopton) Kryetari. Të gjithë anëtarët e kooptuar të Këshillit Drejtues, i verifikon Kuvendi, në Mbledhjen e radhës. Sekretari dhe Arkëtari (nëse ka) janë anëtar të Këshillit Drejtues, sipas detyrës (ex-officio), pa të drejtë vote.
2. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet me vota të fshehta, sipas Neni 16. të këtij Statuti. Anëtarët e Këshillit Drejtues mundë të zgjidhen për mandate të njëpasnjëshme, në kohëzgjatje prej më së shumti 12 vite, duke përfshirë edhe periudhën e kaluar në atë pozitë, përpara miratimit të këtij Statuti.
3. Anëtarit të Këshillit Drejtues i ndërpritet mandati, në rastet në vijim:
  - 3.1. vdekja
  - 3.2. dorëheqja
  - 3.3. tri mungesa pa arsye në mbledhjet e Këshillit Drejtues, edhe pse është njoftuar me rregull dhe nuk ka dërguar kurrfarë arsytimi të vlefshëm për mungesë në mbledhje
  - 3.4. sipas vendimit të Kuvendit të Përgjithshëm. Në këtë rast, përshtatshmërisht do të zbatohen nenet për suspendimin dhe përjashtimin e klubeve anëtare të FSHSK-së
4. Nëse numri i anëtarëve të Këshillit drejtues për çfarëdo arsye qoftë zvogëlohet për një të tretën e anëtarëve, Këshilli drejtues mund të pranojë anëtarë të rinj, mandati i të cilëve zgjatë për kohën e mbetur të Këshillit Drejtues. Në rast se numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues zvogëlohet për më shumë se një të tretën, Këshilli Drejtues ka për detyrë të thërrasë Kuvendin e jashtëzakonshëm të FSHSK-së për zgjedhjen plotësuese të anëtarëve të Këshillit Drejtues.
5. Mbledhjet e Këshillit Drejtues mbahen sipas nevojës, por të paktën katër herë në vit. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të vlefshme vetëm nëse të paktën 6 anëtarët e Këshillit Drejtues janë pro vendimit.
6. Mbledhjet e Këshillit Drejtues ftohen dhe udhëhiqen nga Kryetari. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit, si dhe për shpërndarjen e tij tek anëtarët e Këshillit Drejtues, brenda 7 ditëve pas Mbledhjes.
7. Këshilli Drejtues, për punën e vetë, i përgjigjet Kuvendit të FSHSK-së

## Neni 22. Autorizimet e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ka autorizimet e dhëna sipas këtij Statuti, si dhe autorizimet me të cilat është ngarkuar nga Kuvendi i Përgjithshëm, në veçanti si vijon:
  - 1.1. të menaxhojë, administrojë dhe udhëheqë FSHSK-në, fondet dhe pasurinë e saj, në përputhje me këtë Statut, Planin Strategjik, buxhetin dhe politikat e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi i FSHSK-së
  - 1.2. të hartojë Planin Strategjik, Planin e Punës, Planin Buxhetor dhe t'ia propozojë Kuvendit për miratim
  - 1.3. të hartojë propozimet për ndryshim në Rregulloren e punës së Kuvendit dhe Rregulloren e Punës së Këshillit Drejtues, dhe t'ia dorëzojë ato Kuvendit për miratim
  - 1.4. të hartojë raportin e punës dhe raportin financiar, dhe t'ia dorëzojë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, si dhe të ofrojë sqarime dhe komente të nevojshme, sipas kërkesës së delegatëve të Kuvendit
  - 1.5. të kujdeset që vendimet e Kuvendit të FSHSK-së të zbatohen
  - 1.6. të mbrojë interesat e shenjëtarisë sportive në Kosovë dhe të punojë në promovimin dhe masivizimin e këtij sporti
  - 1.7. të emërojë dhe shkarkojë Sekretarin e Përgjithshëm, pas propozimit të Kryetarit
  - 1.8. të miratojë Rregulloret për punën e organeve dhe komisioneve të FSHSK-së, në përputhje me këtë Statut dhe vendimet e Kuvendit
  - 1.9. sipas nevojës, të bëjë propozime lidhur me anëtarësimin apo ndërprerjen e anëtarësimin të FSHSK-së në ndonjë organizatë vendore, apo ndërkombëtare
  - 1.10. të caktojë komisione ad-hoc për shqyrtimin e çështjeve që duhet të shqyrtohen nga Kuvendi
  - 1.11. të caktojë delegatët, referët dhe përfaqësuesit dhe garuesit, për garat kombëtare e ndërkombëtare, në të cilët marrin pjesë garuesit nga klubet anëtare, ose nga përfaqësuesja
  - 1.12. të vendosë për datën, kohën dhe vendin për mbajtjen e Kuvendit të FSHSK-së
  - 1.13. të vendosë për selinë, dhe shenjat e FSHSK-së
  - 1.14. të zgjedhë dy Nënkryetarët nga mesi i anëtarëve të vetë
  - 1.15. të miratojë draft-buxhetin dhe planin vjetor të punës
  - 1.16. të vendosë për çështjet e anëtarësimin, pezullimit, apo përjashtimit të anëtarëve
  - 1.17. të caktojë komisione tjerë ad-hoc, për çështje që janë me rëndësi për punën e Këshillit Drejtues, apo për misionin e FSHSK-së, duke përfshirë numrin e anëtarëve të tyre, qëllimin dhe mënyrën e punës
  - 1.18. të vendosë mbi tarifën, duke përfshirë për anëtarësi, licencim të klubeve, licencim të garuesve, tarifën për shërbimet profesionale, etj.
  - 1.19. të ofrojë mbështetje për klubet anëtare, në përputhje me mundësitë profesionale e materiale, në përputhje me Strategjinë e miratuar, si dhe në përputhje me Rregullat dhe Rregulloret e miratuara paraprakisht, me qëllim të përmirësimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së tyre
  - 1.20. të vendosë mbi çështjet të cilat, sipas këtij Statuti, nuk janë të rezervuara për Kuvendin e FSHSK-së
2. Këshilli drejtues I FSHSK-së, mes tjerash, kryen funksionet në vijim:
  - 2.1. Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera që i miraton Kuvendi;
  - 2.2. Nxjerr Rregulloren për licencimin e klubeve dhe shoqatave;

- 2.3. Ekzekuton vendimet, konkluzionet dhe politikat e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi;
  - 2.4. Nxjerr rregullore tjera të brendshme që nuk janë në kompetencë të Kuvendit të Federatës;
  - 2.5. Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës;
  - 2.6. Formon trupa punuese të veta, emëron dhe shkarkon anëtarët e tyre;
  - 2.7. Përcakton strukturën organizative të Federatës, duke miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Federatës;
  - 2.8. Disponon me pasurinë e Federatës;
  - 2.9. Miraton propozicionet dhe kalendarin e garave;
  - 2.10. Bartë të drejtën e organizimit të garave nën kompetencë Federatës;
  - 2.11. Miraton Rregulloren e Garave
  - 2.12. Miraton Rregulloren për Kalimin dhe Regjistrimin e garuesve;
  - 2.13. Miraton Rregulloren Disiplinore;
  - 2.14. Miraton sistemin e garave për të gjitha kategoritë;
  - 2.15. Miraton Rregullorën mbi rregullat e përgjithshme teknike të garave;
  - 2.16. Miraton Rregulloren mbi të drejtat dhe transmetimet audio vizuale;
  - 2.17. Miraton Rregulloren për agjentë/kompanitë e kontraktuara për sponsorizim të FSHSK-së;
  - 2.18. Vendos për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve për kryerjen e punëve të përhershme dhe përkohshme në Federatë, dhe lartësinë e pagave të tyre;
  - 2.19. Miraton Rregulloren për Punën e Komisionit Arbitrar;
  - 2.20. I raporton Këshillit Mbikëqyrës mbi veprimtarinë e vet dhe mbarëvajtjen ligjore dhe financiare të Federatës, së paku dy herë në vit;
  - 2.21. Miraton Rregulloren për Shpalljen e Laureatëve të Vitit të Shenjëtari Sportive;
  - 2.22. Miraton Rregulloren e Anti-Doping; dhe
  - 2.23. Miraton Kodin Etik të FSHSK-së-së.
3. Këshilli Drejtues mund të formojë trupa punuese (Këshilla dhe Komisione) të përhershme apo përkohshme, tek të cilat mund t'i delegojë kompetencat e veta. Në raste të tilla, K.D emëron dhe shkarkon sipas vlerësimit të vet anëtarët e këtyre trupave dhe përcakton kompetencat dhe kohëzgjatjen e ekzistimit të tyre. Këto trupa punuese për veprimtarinë e tyre i përgjigjen K.D.
  4. Funksionimi, mandati, procedurat, dhe autorizimet në lidhje me veprimtarinë e këtyre trupave punues do të rregullohen me Rregulloren mbi Punën e Bordit, si dhe rregulloret përkatëse për këto trupa.
  5. Trupa të përhershme punuese të K.D janë:
    - 3.1. Këshilli Profesional;
    - 3.2. Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e garuesve;
    - 3.3. Komisioni disiplinor;
    - 3.4. Komisioni i garave, mandati i të cilit zgjatë vetëm një edicion garues;
    - 3.5. Komisioni arbitrar
  6. Këshilli Drejtues do të vendosë për çështje, për të cilat nuk është autorizuar sipas këtij Statuti, e për të cilat nuk mundet të pritët deri në një Kuvend të Jashtëzakonshëm. Në raste të tilla, vendimet e Këshillit Drejtues duhet të jenë në përputhje me rregullat e KOK-ut, KON-it, ISSF-së, apo organeve tjera relevante. Në rast se këso rregullore nuk ekziston, Këshilli Drejtues duhet të vendos në pajtim me detyrën që të veprojë në mënyrë të drejtë.

### **Neni 23. Këshilli Mbikëqyrës**

1. Këshillin Mbikëqyrës (KM) e zgjedh Kuvendi i Federatës, nga radhët e anëtarëve të klubeve anëtar, të cilët nuk janë të deleguar në Kuvendin e Federatës ose anëtarë tjerë.
2. Këshilli Mbikëqyrës (KM) përbëhet nga 3 anëtar.
3. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jetë anëtar i organit tjetër ose trupit punues të Federatës. Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës e zgjedhin anëtarët e zgjedhur, nga përbërja e tij.
4. Mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës e thirr Kryetari i FSHSK-së. Mbledhjet tjera të Këshillit Mbikëqyrës i thirr Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, sipas nevojës, e së paku një herë në vit. Mbledhjet mbahen në praninë e shumicës së anëtarëve. Këshilli Mbikëqyrës merr vendime të plotfuqishme me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
5. Këshilli Mbikëqyrës kontrollon afarizmin e FSHSK-së, përkatësisht aktivitetet e organeve dhe zyrtarëve të FSHSK-së.
6. Këshilli Mbikëqyrës është i autorizuar:
  - 6.1. për kontrollimin e ligjshmërisë së punës së FSHSK-së;
  - 6.2. për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve, konkluzioneve dhe udhëzimeve të miratuara nga Kuvendi i FSHSK-së, Këshilli Drejtues dhe organet tjerë të FSHSK-së;
  - 6.3. për kontrollimin e punëve financiare të FSHSK-së;
  - 6.4. për kontrollimin e punëve dhe obligimeve kontraktuese të FSHSK-së;
  - 6.5. për analizën e realizimit të planit financiar të FSHSK-së.
7. Shërbimi profesional dhe organet tjera të FSHSK-së, janë të obliguara që, Këshillit Mbikëqyrës t'i ofrojnë të gjitha shënimet e kërkuara, t'i mundësojnë shikimin e dokumentacionit dhe t'ia sigurojnë kushtet për punë. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtë të jetë i pranishëm në mbledhjet e të gjithë organeve komisioneve të FSHSK-së, pa të drejtë vote.
8. Për punën e vetë, Këshilli Mbikëqyrës i përgjigjet Kuvendit dhe raporton së paku një herë në vit, duke dhënë edhe propozim për masat e nevojshme. Pas konstatimit të parregullsive, Këshilli Mbikëqyrës e njofton Këshillin Drejtues, përkatësisht Kuvendin e FSHSK-së, si dhe organin në punën e të cilit ka ndodhë parregullsia.
9. Nëse parregullsia e konstatuar nuk mënjanohet në afatin e duhur, Këshilli Mbikëqyrës është i obliguar që për këtë ta njoftojë organin e autorizuar shtetëror.
10. Këshilli Mbikëqyrës punon sipas Rregullores së punës, të cilën e harton dhe ndryshon ky Këshill, kurse e miraton Këshilli Drejtues.

### **Neni 24. Kryetari dhe Nënkyetarët e FSHSK-së**

- 1.—Kryetari është zyrtari më i lartë i FSHSK-së. Kryetari është edhe Kryetar i Këshillit Drejtues dhe Kryesues i Mbledhjeve të Kuvendit të FSHSK-së, ndërmjet dy Kuvendeve Zgjedhore. Nënkyetarët e FSHSK-së i zgjedh Këshilli Drejtues ~~në mesin e anëtarëve të vet, me propozim të Kryetarit.~~
2. Kryetari është udhëheqës dhe drejtues i FSHSK-së. Ai e përfaqëson FSHSK-në dhe kryeson me të gjitha aktivitetet.

3. Kryetari është i autorizuar si vijon:
  - 3.1. të përfaqësojë FSHSK-në brenda dhe jashtë vendit, para institucioneve sportive dhe qeveritare
  - 3.2. të veprojë dhe të nënshkruaj si përfaqësues ligjore i FSHSK-së
  - 3.3. të ftojë dhe të udhëheqë Mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe Mbledhjet e Kuvendit
  - 3.4. të kujdeset për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues
  - 3.5. të veprojë në emër të FSHSK-së sipas nevojës dhe përcaktimeve të këtij Statuti dhe akteve tjera të FSHSK-së
  - 3.6. të kujdeset për zbatimin e këtij Statuti, Rregullave, Rregulloreve, Vendimeve dhe akteve tjera të FSHSK-së
  - 3.7. mbikëqyrë zbatimin e vendimeve dhe aktiviteteve të organeve dhe komisioneve
  - 3.8. të kujdeset për përmbushjen e detyrimeve të FSHSK-së ndaj klubeve anëtare dhe anasjelltas
  - 3.9. të promovojë vlerat olimpike dhe sjelljet sportive, në kuadër të FSHSK-së dhe më gjerë, në kuadër të Lëvizjes Olimpikë në Kosovë
  - 3.10. të kujdeset për përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të FSHSK-së, duke përfshirë përforcimin e marrëdhënieve harmonike me të gjithë partnerët e FSHSK-së
  - 3.11. të kryej detyra tjera, sipas autorizimit nga Këshilli Drejtues, apo nga Kuvendi
4. Nënkryetarët e ndihmojnë dhe e mbështesin Kryetarin në kryerjen e detyrave të caktuara nga Këshilli Drejtues dhe/apo Kuvendi i FSHSK-së.
5. Nënkryetarët janë të autorizuar të ushtrojnë detyrat e Kryetarit, në mungesë, apo pamundësi të tij. Nënkryetarët veprojnë sipas autorizimit nga Kryetari, apo nga Këshilli Drejtues.

### **Neni 25. Zgjedhja e Kryetarit dhe Këshillit Drejtues**

1. Kuvendi i Përgjithshëm, përpara Kuvendit të ardhshëm Zgjedhor, do të zgjedhë Komisionin Zgjedhor, në përbërje prej së paku 3 anëtarëve të rregullt dhe 2 anëtarëve rezervë. Prej anëtarëve të rregullt, Kuvendi do të emëroj Kryetarin e këtij Komisioni. Asnjë nga anëtarët e këtij Komisioni, nuk do të jetë kandidatë për Kryetar, apo të jetë i afërm me një kandidat të tillë.
2. Komisioni Zgjedhor do të udhëheq procesin zgjedhor në tërësi (nga pranimi i nominimeve e deri tek shpallja e rezultateve).
3. Formularët për nominim duhet t'u dërgohen të gjithë klubeve anëtare të FSHSK-së, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraparë e Kuvendit Zgjedhor, së bashku me materialet e tjera për Kuvend. Nominimet do të pranohen për pozitën e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues.
4. Formulari i plotësuar për nominim, së bashku me pajtimin me shkrim të Klubit që e nominon, duhet të arrijnë në Komisionin Zgjedhor jo më vonë se 14 ditë para datës së Mbledhjes së Kuvendit Zgjedhor. Së bashku me paraqitjen e nominimit të tyre, kandidatët duhet të dërgojnë një prezantim të vetes së tyre (CV).
5. Të nominuarit për pozitën e Kryetarit duhet të jenë anëtar ekzekutiv të një Klubi anëtar të FSHSK-së. Nga kjo rregull, përjashtohet personi i cili aktualisht ushtron detyrën e Kryetarit të FSHSK-së. Kandidatët për pozitën e Kryetarit, së bashku me nominimin e tyre, do të dërgojnë edhe një përmbledhje të shkurtër të vizionit dhe programit të tyre për zhvillimin e mëtutjeshëm të FSHSK-së
6. Të nominuarit për pozitën e Kryetarit duhet të plotësojnë së paku këto kritere:



- 6.1. të jenë shtetas të Kosovës, me banim të përhershëm në Kosovë
  - 6.2. të ketë të përfunduar shkollimin universitar
  - 6.3. të ketë përvojë në organizimin e sportit dhe njohuri të Lëvizjes Olimpike
  - 6.4. të njeh së paku njërën nga gjuhët zyrtare të ISSF-së
7. Komisioni Zgjedhor do të shqyrtojë nominimet e pranuar dhe do të njoftojë delegatët me të drejtë vote, të Kuvendit të FSHSK-së me emrat dhe biografinë e shkurtër të kandidatëve të përshtatshëm, jo më vonë se 10 ditë para zgjedhjeve. Çfarëdo ankese, apo kundërshtimi lidhur me kandidatët e nominuar, delegatët me të drejtë vote, duhet ta paraqesin tek Komisioni Zgjedhor, jo më vonë se 8 ditë përpara zgjedhjeve. Komisioni Zgjedhor do t'i shqyrtojë ankesat dhe do të marr vendim, jo më vonë se 6 ditë para zgjedhjeve dhe për këtë do t'i njoftojë të gjithë delegatët me të drejtë vote.
  8. Në rast se Komisioni Zgjedhor nuk ka arritur të marr vendim lidhur me përshtatshmërinë e kandidatëve, apo lidhur me ndonjë ankesë të pranuar brenda afatit të përcaktuar, apo për çfarëdo çështje lidhur me zgjedhjet, e cila nuk ka arritur të zgjidhet brenda afateve të paraqitura më lartë, Komisioni Zgjedhor, do t'ia parashtrojë Kuvendit Zgjedhor. Këto çështje, do t'i paraqiten Kuvendit si pikë e veçantë e Rendit të Ditës, përpara fillimit të procesit zgjedhor.
  9. Komisioni Zgjedhor me Sekretarin e Përgjithshëm, do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen teknike të zgjedhjeve (lista e delegatëve të Kuvendit me të drejtë vote; kutia transparente e votimit; si dhe fletët e votimit me emrat e kandidatëve të nominuar, të verifikuara me vulën e FSHSK-së dhe nënshkrimin e Sekretarit të Përgjithshëm) dhe do t'ua sqarojnë procedurën të pranishmeve, duke u përgjigjur edhe në çfarëdo pyetje që mundet të paraqitet nga delegatëve me të drejtë vote.
  10. Pasi të gjithë delegatët me të drejtë vote që janë të pranishëm, të kenë hedhur votën e tyre, Komisioni Zgjedhor do të hap kutinë e votimit dhe do t'i numërojë votat publikisht. Llogaritja e votave do të bëhet sipas Neni 16.

### **Neni 26. Sekretari i Përgjithshëm**

1. Sekretari i Përgjithshëm është udhëheqës i administratës së FSHSK-së dhe mbikëqyrë të gjitha punët që kryhen në selinë e FSHSK-së
2. Sekretari i Përgjithshëm duhet të jetë administrator profesionist, me një kontratë pune, i cili duhet të demonstrojë cilësi dhe shkathtësi të përshtatshme për të kryer funksionin e tillë me sukses.
3. Sekretari i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Drejtues, me propozim të Kryetarit. Për të gjetur kandidatin më të përshtatshëm për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, mundet të zhvillohet edhe konkurs publik.
4. Sekretari i Përgjithshëm duhet të:
  - 4.1. menaxhojë financat, administratën dhe stafin e FSHSK-së
  - 4.2. monitorojë, mbikëqyrë dhe sipas nevojës raportojë për punën e klubeve anëtare të FSHSK-së, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues dhe/apo të Kuvendit, dhe sipas udhëzimeve të Kryetarit të FSHSK-së
  - 4.3. ndërmarr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për të përgatitur Mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe Mbledhjet e Kuvendit të FSHSK-së dhe merr pjesë aktive në këto mbledhje

- 4.4. kujdeset për ligjshmërinë dhe dokumentojë të gjitha vendimet e Këshillit Drejtues, Kuvendit dhe organeve tjera të FSHSK-së
  - 4.5. përpilojë procesverbalet e Mbledhjeve të Këshillit Drejtues dhe të Mbledhjes së Kuvendit të FSHSK-së, si dhe ta shpërndajë atë me kohë, sipas përcaktimeve të këtij Statuti
  - 4.6. mbajë regjistrin e klubeve anëtare të FSHSK-së, sipas përcaktimeve të këtij Statuti
  - 4.7. koordinojë punën e organeve tjerë dhe komisioneve të FSHSK-së, si dhe t'i furnizojë ata me dokumentacionin e nevojshëm, përpara mbledhjeve të tyre
  - 4.8. përmbushë detyrat administrative të FSHSK-së, që përfshinë korrespondencën e FSHSK-së, përgatitjen e shkresave, raporteve, kontratave, etj, si dhe dërgimin e ftesave e dokumenteve tjerë, sipas nevojës
  - 4.9. monitorojë/përcjellë aktivitetet dhe vendimet e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, ku është anëtarësuar FSHSK-ja, përmes informimit, konsultimit me vendimet e organeve kompetent të FSHSK-së,
  - 4.10. përgatis propozimet për planin e punës, planin financiar, raportet mbi aktivitetet dhe pasqyrat financiare të FSHSK-së, draftet, propozimet e akteve normative dhe të tjera, të cilat i miratojnë dhe nxjerrin organet e FSHSK-së
  - 4.11. koordinojë dhe ndërmer masa të duhura për t'i përmbushur detyrimet dhe për t'i mbrojtur interesat e FSHSK-së dhe Republikës së Kosovës, para këtyre organizatave dhe organeve shtetërore
  - 4.12. kryej detyrat e Arkëtarit, nëse Këshilli Drejtues nuk ka emëruar një person tjetër në këtë detyrë
  - 4.13. kryej punë dhe detyra tjera, sipas udhëzimeve, urdhrave dhe vendimeve të Këshillit Drejtues, Kryetarit dhe/apo Kuvendit të FSHSK-së
5. Me propozim të organeve, trupave punuese ose anëtarëve të FSHSK-së, mandati i Sekretarit të Përgjithshëm mund të ndërpritet nëse:
    - 5.1. nuk zbaton apo nuk respekton afatet për zbatimin e vendimeve dhe konkluzioneve të organeve të FSHSK-së
    - 5.2. nëse nga pakujdesia, ose puna jo profesionale, ose e paligjshme i ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale FSHSK-së
    - 5.3. nëse ka shkaktuar dëme tjera dhe ka rrezikuar interesat e FSHSK-së dhe/apo të Republikës së Kosovës.

### **Neni 27. Arkëtari**

1. Nëse vëllimi i punës e kërkon, Këshilli Drejtues mundet të vendosë të emërojë një person për të kryer detyrat e Arkëtarit. Deri në një emërim të tillë, detyrat e arkëtarit dhe menaxhimin e financave i kryen Sekretari i Përgjithshëm
2. Emërimi dhe shkarkimi i Arkëtarit bëhet në të njëjtën mënyrë si Sekretari i Përgjithshëm.
3. Arkëtari duhet të:
  - 3.1. verifikojë të gjitha pagesat, kotizimet, si dhe çfarëdo pagese tjetër, që bëhet në llogari të FSHSK-së
  - 3.2. pranojë të gjitha faturat dhe kërkesat tjera financiare për llogari të FSHSK-së dhe të planifikojë shlyerjen e tyre nga llogaria e FSHSK-së. Përpara ekzekutimit të çfarëdo pagese, Arkëtari duhet të marr miratimin me shkrim nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm

- 3.3. mbajë në rregull, saktë dhe të përditësuara të gjitha të dhënat për shpenzimet, të hyrat dhe transaksionet e tjera financiare të FSHSK-së, në mënyrë që këto të dhëna të jenë në dispozicion për Sekretarin e Përgjithshëm, Kryetarin (Këshillin Drejtues) dhe për Këshillin Mbikëqyrës
- 3.4. përgatis raportin financiar dhe planifikimin e buxhetit vjetor për Këshillin Drejtues dhe Kuvendin e FSHSK-së
- 3.5. sigurohet që gjendja financiare e FSHSK-së është e audituar me rregull, për çdo vit financiar, nga Auditori i jashtëm, i caktuar nga Kuvendi i FSHSK-së
- 3.6. kryej punë dhe detyra tjera, sipas udhëzimeve, urdhrave dhe vendimeve të Këshillit Drejtues, Sekretarit të Përgjithshëm, Kryetarit dhe/apo Kuvendit të FSHSK-së

### **Neni 28. Komisionet e FSHSK-së**

1. Sipas mundësive buxhetore dhe në përputhje me nevojat aktuale, FSHSK do të themelojë Komisione të përhershme, apo Komisione ad-hoc:
  - 1.1. Komisioni Disiplinor
  - 1.2. Komisioni i Sportistëve (Garuesve)
  - 1.3. Komisioni për Financa dhe Auditim
  - 1.4. Komisioni Ligjor
  - 1.5. Komisioni i ankesave
  - 1.6. Komisioni Statutar
  - 1.7. Komisioni Mjekësor
  - 1.8. Komisioni “Femra dhe Sporti”
  - 1.9. Komisioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare
  - 1.10. Komisioni i Referëve
  - 1.11. Komisioni i Trajnerëve
  - 1.12. Komisioni i Garave
    - 1.12.1. Komisioni për Pistoletë Ajrore
    - 1.12.2. Komisioni për Pushkë Ajrore
  - 1.13. Komisione tjera sipas nevojës
2. Të dy gjinitë duhet të jenë të përfaqësuara nëpër komisione, për aq sa është e mundur
3. Komisionet veprojnë si organe këshilluese. Komisionet do të ndihmojnë, mbështesin dhe këshillojnë organet e FSHSK-së, lidhur me të gjitha çështjet brenda fushës së tyre të veprimit. Organet e FSHSK-së, përpara vendimmarrjes, do të marrin mendimin e Komisionit përkatës.
4. Anëtarësia në Komisione është personale dhe nuk lejohet përfaqësimi përmes autorizimit (Proxy)
5. Ndonëse anëtarët individual të komisioneve të FSHSK-së mundën të sjellin njohuritë, përvojat dhe shkathtësitë e veta nga klubet e veta, ata duhet të ushtrojnë detyrat e veta si anëtar të një organi, apo komisioni të FSHSK-së në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke pasur parasysh vetëm interesat e FSHSK-së si tërësi
6. Kryesuesit dhe anëtarët e Komisioneve profesionale, duhet të kenë licencat përkatëse, që përputhen me punën e komisionit (p.sh. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit të Referëve, duhet të jenë referë të licencuar, etj)
7. Me rastin e themelimit të një Komisioni, Këshilli Drejtues miraton Rregulloren e Punës për secilin Komision, duke përfshirë edhe çështjet e vendimmarrjes, duke mos ndikuar në të

drejtat vendimmarrëse dhe ekzekutive të Këshillit Drejtues, apo të Kuvendit të FSHSK-së. Me këtë rast, bazë për caktimin e detyrave, autorizimeve dhe mënyrës së punës së Komisionit, do të jenë aktet përkatëse të KOK-ut dhe ISSF-së.

## **V. FINANCAT DHE FUNKSIONIMI I FSHSK-së**

### **Neni 29. Financat**

1. Viti fiskal i FSHSK-së fillon më 01. Janar dhe përfundon më 31. Dhjetor.
2. Financat e FSHSK-së rrjedhin nga:
  - 2.1. Anëtarësia, kotizimi, licencimi dhe të hyrat tjera nga klubet anëtare
  - 2.2. Mbështetja nga Departamenti i Sportit dhe autoritetet tjerë të Qeverisë së vendit
  - 2.3. Mbështetja nga KOK-u
  - 2.4. Mbështetja nga ISSF-ja
  - 2.5. Mbështetja nga Solidariteti Olimpik dhe nga organizatat tjera të Lëvizjes Olimpike
  - 2.6. Të hyrat që rrjedhin nga marketingu dhe aktivitetet sponsorizuese, në pajtim me Kartën Olimpikë, këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi
  - 2.7. Donacionet dhe grantet të dedikuara për veprimtarinë e FSHSK-së, që janë në përputhje me Kartën Olimpikë, këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi
  - 2.8. Çdo burim tjetër legjitim, në përputhje me Kartën Olimpikë, këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi
3. Të gjitha të hyrat nga mbështetja, donacionet dhe grantet, të pranuar nga entitetet vendore dhe ndërkombëtare, duhet të shfrytëzohen përpikëmerisht për qëllimin për të cilin janë pranuar.
4. Planin financiar dhe raportet financiare, i përgatit Sekretari për Këshillin Drejtues, ndërsa i miraton Kuvendi i FSHSK-së
5. Në çdo Mbledhje të Këshillit Drejtues, Sekretari i Përgjithshëm (ose Arkëtari, nëse është i emëruar) duhet të raportojnë për gjendjen financiare të FSHSK-së
6. Për shërbimet e kontabilitetit dhe financave, Këshilli Drejtues mund të angazhoj kompani profesionale, me kusht që këto shërbime të jenë me kosto me të lirë se sa angazhimi i një Arkëtari.

### **Neni 30. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo pakënaqësi, ose mosmarrëveshje për çështje sportive, që lindë brenda organeve të FSHSK-së, ose në mes të FSHSK-së dhe klubeve anëtare, do të zgjidhet nga organet drejtuese të FSHSK-së (Këshilli Drejtues dhe pastaj Kuvendi). Nëse palët nuk janë të kënaqura me vendimin e organeve të FSHSK-së, çështja do t'i kalohet për shqyrtim komisioneve dhe/apo organeve përkatëse të KOK-ut, ose ISSF-së, në varësi prej kompetencave për rastin konkret. Në rastet e tilla, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Statutit të KOK-ut, apo ISSF-së.
2. Për çështjet që nuk kanë të bëjnë me sportin, palët mund të merren vesh në procedurë jashtë gjyqësore, ose çështja i kalon Gjykatës Themelore, në Prishtinë.
3. Gjuha e shqyrtimit brenda FSHSK-së dhe KOK-ut, do të jetë gjuha shqipe, ndërsa në rast të shqyrtimit në institucionet ndërkombëtare, shqyrtimi do të jetë në gjuhën zyrtare të atij organi.

4. Për afatet dhe çështjet tjera në procedurë, do të zbatohen përshtatshmërisht, dispozitat e Ligjit mbi procedurën kontestimore.

#### **Neni 31. Ndryshimet e Statutit**

1. Propozimet për ndryshimin e Statutit duhet t'i dorëzohen Sekretarit të Përgjithshëm, së paku 30 ditë përpara datës së caktuar për Mbledhjen e Kuvendit të FSHSK-së. Sekretari do t'ia shpërndajë klubeve anëtare, amendamentet e propozuara, më së largu 15 ditë përpara datës së caktuar për Mbledhjen e Kuvendit të FSHSK-së.
2. Kuvendi i FSHSK-së mundet të vendosë për ndryshimet në Statut, vetëm nëse së paku gjysma e anëtarëve të FSHSK-së kanë dërguar delegatët në Kuvend. Që ndryshimet të bëhen të vlefshme, për ta duhet të votojnë së paku 2/3 e votave të delegatëve që janë të pranishëm.

#### **Neni 32. Shpërbërja e FSHSK-së**

1. Kërkesa për shpërbërjen e FSHSK-së duhet të pranohet nga Sekretari i Përgjithshëm, së paku 2 muaj përpara datës së Kuvendit të Përgjithshëm. Sekretari do t'ua përcjellë kërkesën të gjithë klubeve anëtare të FSHSK-së, së paku një muaj përpara datës së Kuvendit të Përgjithshëm.
2. Kuvendi i FSHSK-së mundet të vendosë për shpërbërjen e vet, vetëm nëse së paku 2/3 e anëtarëve të FSHSK-së kanë dërguar delegatët në Kuvend. Shpërbërja duhet të miratohet nga së paku 3/4 e votave të delegatëve që janë të pranishëm.
3. Në rast të shpërbërjes së FSHSK-së, të gjitha obligimet, si dhe të mirat materiale të grumbulluara në mënyrë të ligjshme në emër të FSHSK-së, do t'i kalohen si donacion, pasardhësit ligjor. Nëse në kohën e shpërbërjes së FSHSK-së nuk ka ndonjë pasardhës të ligjshëm, atëherë, të gjitha mjetet do t'i kalohen një organizate tjetër, misioni, objektivat dhe veprimtaria e së cilës është e ngjashme me atë të FSHSK-së, në konsultim paraprak me KOK-un.

#### **Neni 33.**

#### **Përgjegjësit e përcaktuara me Ligjin për parandalimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive**

1. FSHSK i njej dhe i kupton të gjitha përgjegjësitë që i përcaktohen me Ligjin Nr. 05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive. Organet e FSHSK-së, e veçanërisht Komisioni i Garave, do të bashkëpunojnë ngushtë me Këshillin për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive (Këshilli për Sport) për zbatimin e këtij ligji.

**VI. ÇËSHTJET KALIMTARE**  
**Neni 34. Çështjet kalimtare**

1. Të gjitha vendimet e FSHSK-së, të cilat janë miratuar sipas Statutit të kaluar, do të mbesin të vlefshme deri në zbatimin e tyre, ose deri sa të ndryshohen nga organet që i kanë miratuar ato.
2. Të gjithë personat që janë zgjedhur nëpër organet e FSHSK-së sipas Statutit të kaluar, do ta përfundojnë mandatin e tyre.
3. Të gjitha klubet anëtare të FSHSK-së, duhet ta përshtatin Statutin e tyre me këtë Statut, si dhe të gjitha rregulloret e tyre që rrjedhin nga ky Statut deri në Kuvendin e tyre të radhës, e më së largu deri në fund të muajit Nëntor 2022, dhe kopjen e Statutit të ri, së bashku me kopjen e procesverbalit të Mbledhjes së Kuvendit në të cilin është miratuar Statuti, t'ia dorëzojnë Sekretarit të FSHSK-së

Prishtinë 11/11.2022

Kryetari i FSHSK-së

Gëzim Hazrolli

